

VENDIM
Nr.21, datë 8.3.2010

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË “HEC I TERVOLIT” PËR KUALIFIKIMIN E IMPIANTIT PRODHUES
(HEC I TERVOLIT) SI BURIM I RINOVUESHËM ENERGJIE**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa “ll”, 9 dhe 39 të ligjit nr.9072, datë 22. 5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” neni 18, dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.9, datë 21.2.2007 “Për miratimin e rregullave dhe procedurave të certifikimit të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme”, neni 8, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.3.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Hec i Tervolit” sh.p.k., për kualifikimin e impianteve prodhuese (Hec i Tervolit) si burime të rinovueshme energjie, dhe konstatoi rregullshmërinë e paraqitjes së aplikimit të shoqërisë “Hec i Tervolit”.

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “Hec i Tervolit” për kualifikimin e impianteve prodhuese (Hec i Tervolit) si burime të rinovueshme energjie.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin lidhur me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta